



## **Tezë Masteri**

# **Sfidat e tregut të punës së gjinisë së re femrore në vendet në zhvillim – Rast studimi Republika e Maqedonisë**

**Kandidati:**

**Besnike Ademi**

**Mentor:**

**Prof.Dr.Selajdin Abduli**

**Shtator, 2020**

## **DEKLARATË NDERI**

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se kjo tezë e masterit dhe puna e bërë këtu, është plotësisht punë origjinal. Informatat e marra nga punimet, librat dhe revistat e botuara ose të pabotuar të autorëve është cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve.

## PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1 – HYRJE.....	6
1.1. Lënda e hulumtimit .....	6
1.2. Qëllimet e hulumtimit .....	7
1.3. Hipotezat .....	7
1.4. Metodologjia e hulumtimit .....	8
1.5. Strukturimi i punimit .....	8
1.6. Përfundimi.....	9
KAPITULLI 2 – SHQYRTIMI I LITERATURES MBI TREGUN E PUNËS NË RMV DHE PJESËMARRJES SË FEMRAVE NË TË .....	10
KAPITULLI 3 – SFIDAT DHE KARAKTERISTIKAT E PERIUDHES SE KALIMIT TË FEMRAVE TË REJA NË RMV NË TREGUN E PUNËS.....	24
1. Shkollimi i mbaruar .....	24
2. Aktiviteti ekonomik bazik.....	31
3. Të rinjët që ende nuk kanë filluar tranzicionin nga shkollimi në punësim .....	40
4. Të rinjët në prag të kalimit në tranzicion.....	41
5. Të rinjët kanë përfunduar kalimin e pragut në tregun e punës .....	43
6. Rruga dhe kohezgjatja e kalimit të pengesave .....	47
KAPITULLI 4 – METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE MODELI EKONOMETRIK.....	51
1. Karakteristikat e mostrës.....	51
2. Përshkrimi dhe definimi i variablave për model.....	66
3. Modeli ekonometrik i përdor.....	67
4. Rezultatet e fituara .....	68
5. Testimi i hipotezave .....	70
KONKLuzionet dhe rekomandimet .....	71
BIBLIOGRAFIA.....	73

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1 - Norma e punësimit, papunësisë dhe aktive, sipas gjinisë .....	19
Tabela 2 - Papunësia afatgjate në RVM (sipas gjinisë) .....	21
Tabela 3 - Niveli I shkollimit I te rinjeve ne vitet 2012 dhe 2014 .....	24
Tabela 4 - Të dhënat nga të anketuarit për përfundimin e shkollimit krahasuar me prindërit e tyre (në %).....	27
Tabela 5 - Drejtimet e preferueshme për studim nga të rinjtë .....	29
Tabela 6 - Norma e NEET në RMV.....	35
Tabela 7 - Kohëzgjatja e papunësisë tek të rinjtë në RVM .....	36
Tabela 8 - Metodatat të cilit të rinjtë e papunë përdorin për të gjetur punë .....	39
Tabela 9 - Të rinjtë të cilët ende nuk kanë filluar tranzicionin .....	41
Tabela 10 - Ndarja e të rinjëve në nënkategori dhe në bazë të karakteristikave të tjera që kaluan kufirin e tranzicionit nga shkollimi në punësim.....	42
Tabela 11 - Ndarja e të rinjëve me kufij të kaluar në nënkategori me veçori të caktuara karakteristike .....	44
Tabela 12 - Kohëzgjatja e kalimit nga mbarimi I shkollimit në tregun e punës sipas gjinis (dhe muajt).....	48
Tabela 13 - Rezultatet e testimit (koeficienti dhe efekti marginal) .....	68

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1- Norma e papunësisë në RMV .....	16
Figura 2 - Norma aktive dhe norma e punësimit në RMV .....	18
Figura 3 - Punësimi formal kundrejt punësimit joformal .....	23
Figura 4 - Ndarja në bazë të ardhurave që posedojn të rinjët për arritjen në nivelin adekuat të shkollimit.....	28
Figura 5 - Preferencat e studentëve aktual për llojin e punës që duan në të ardhmen (në %) ..	30
Figura 6 - Krahasim i gjinive në bazë të aktiviteteve të tyre ekonomike.....	31
Figura 7 - Dallimi në mes të rinjëve bazuar në diskrepancën e aktivitetit ekonomik .....	33
Figura 8 - Shkalla e papunësisë tek të rinjët bazuar në nivelin e shkollimit.....	35
Figura 9 - Të rinjët e papunë dhe të ardhurat e tyre familjare.....	37
Figura 10 - Papunësia tek të rinjët bazuar në pengesat për të gjetur punë.....	38
Figura 11 - Kalimi I caktuar të të rinjëve në bazë nivelit mbarimit shkollimit dhe gjinise .....	46
Figura 12 - Punësimet aktuale me qëndrueshmëri me/ose të pakënaqëshme (në kategorin “si kaluese”) deri tek punësimet e para.....	48
Figura 13 - Kohezgjatja e periudhës të kalimit nga shkollimi në tregun e punës deri arritjen në punën e pare stabile e të kënaqëshme sipas gjinis (për muaj) .....	50

### 1.1. Lënda e hulumtimit

Gjinia femërore jo çdoher ka qenë e privilegjuar me të drejtat e saja, të cilat janë njohur dhe respektuar. Andaj në këtë punim të masterit do të fokusohemi në tranzicionin që femra ka pësuar nga shkollimi deri në punësim, në një theks të vaçant për vendet e R.M-së. Edhe pse diskriminimi gjinor daton shumë herët mirëpo ka qenë e manifestuar në mënyra të ndryshme për vende të ndryshme.

Andaj me cenimin e këtyre të drejta njerëzore paraqiten barrierat që pengojnë në emancipimin e plotë të femrës për të kontribuar në tregun e punës me aftësit e saja intelektuale përkundrazi gjinis mashkullore që gjithmonë e kanë poseduar këtë të drejtë. Inicativat për emancipimin e femrës në shoqëri e kanë mundësuar shtetet e zhvilluara nëpërmjet hartimit të projekt ligjeve, që sigurojnë barazin e të dyjave gjinive në të gjithë sferat e jetës . Ku shtetet e BE-së më së miri e deshmojnë nëpërmjet konventës ligjore të nenit 10 dhe 11 ku theksojnë që të sigurohen të drejta të barabarta në arsimim për femrën ashtu siç është për meshkujt duke asimiluar edhe diskriminimin e femrës në punësim .

Gjithashtu edhe në Maqedoni barazin në mes dy gjinive më së miri e definojnë ligji gjithëpërfshirës (*lex generalis i lex specialis*) i cili mbron të drejtat dhe detyrimet për të rregulluar arritjen e barazisë gjinore në mes meshkujve dhe femrave.

Ligji i cili rregulloi çështjen për trajtim të barabart mes meshkujve dhe femrave së pari u miratua në vitin 2006. Në vitin 2008 po e njëjta u rimiratua nga direktivat e BE-së dhe katër vite më vonë u soll një ligj i ri i cili avancoi më tej çështjen për krijim të mundësive të barabarta ndërmjet dy gjinive. Ligji i ri i ruajti dispozitat paraprake ligjore si dhe vendosi edhe masa të veçanta ligjore që forcoi detyrimet e palëve përgjegjëse për ofrim të mundësive të barabarta për meshkujt dhe femrat. Ky ligj gjithashtu forcoi edhe më shumë detyrimet dhe përgjegjësit e subjekteve dhe personave përgjegjës (siç janë koordinatorët dhe zëvendës koordinatorët, pushteti lokal si dhe autoritet shtetërore) duke e kyçur perspektivën e barabartësis gjinore në planet strategjike buxhetore, ku raportet vjetore do të paraqesin me qartë faktorët që sjellin

efektet të kundërta për meshkujt dhe femrat në planet strategjike si dhe niveli implementimi të ligjit (neni 11, 12,14) në ato plane.

Mirëpo pavarësisht gjithë këtyre legjislacioneve që luftojnë për barazinë gjinore si dhe që të respektohen dhe të zbatohen në përditshmëri mirëpo pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike në nivel lokal është ende i ulët. Andaj në këtë temë magjistrature do të shtjellojmë në paprekshmëri efektet pozitive edhe negative që ndikojnë në këtë rezultat si dhe indikatorët që do të mundësonin në përmirësimin e këtij rezultati.

## **1.2. Qëllimet e hulumtimit**

Qëllimet e këtij punimi të masterit janë si vijon:

- Të hulumtoj qasjet teorike të pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës
- Të analizoj aspektet statistikore mbi femrat e reja dhe qasja e tyre në tregun e punës
- Të analizoj faktorët që ndikojnë tek punësimi i femrave të reja
- Të analizoj faktorët që kanë ndikim në kalimin e femrave të reja nga shkollimi drejt tregut të punës

## **1.3. Hipotezat**

Në këtë punim të masterit do të hedhim gjithsej 3 hipoteza, të cilat do të testohen përmes të dhënave të përpunuara në programin STATA, përmes modelit ekonometrik. Këto tre hipoteza janë si vijon:

H1: Edukimi si faktor ndikon pozitivisht në uljen e periudhes se kalimit të femrave të reja drejt tregut të punës

H2: Gjendja e mirë ekonomike e familjes është e lidhur pozitivisht me uljen e periudhes se kalimit të femrave të reja pra në gjetjen më lehtë të një vend pune.

H3: Gjinia si faktor ndikon negativisht në periudhen e kalimit te femrave të reja drejt një vendi të punës

## **1.4. Metodologjia e hulumtimit**

Në përpunimin e këtij punimi hulumtues – shkencor, duke parë lëndën dhe qëllimet e hulumtimit do të përdoren metoda dhe teknika të përgjithshme dhe të veçanta shkencore me ndihmën e të cilave do të arrihet deri në përfundime konkluzive dhe rekomandime. Për konfirmimin e validitetit të hipotezave do të përdorim metoda të ndryshme me qëllim që rezultatet tona të kenë konfidencë shkencore:

- Metodën krahasimore, me të cilën do të krahasohen të dhënat mes gjinive dhe mes disa vendeve
- Metoda statistikore, ku do të analizohen raportet e ndryshme që trajtojnë këtë temë.
- Metoda ekonometrike përmes përdorimit të modelit Probit Regresion.

Të dhënat që do të përdorim në ndërtimin e modelit do të marrim nga institucionet financiare Organizata Botërore e Punës (ILO), e cila ka realizuar anketë gjatë vitit 2014-2015 në RM.

## **1.5. Strukturimi i punimit**

Ky punim i masterit do të përbëhet nga 4 kapituj dhe atë si vijon:

Kapitulli 1 – Hyrje

Kapitulli 2 – Shqyrtimi i literatures mbi tregun e punës në RM dhe pjesëmarrjes së femrave në të

Kapitulli 3 – Sfidat dhe karakteristikat e periudhës së kalimit të femrave të reja në RM në tregun e punës

Kapitulli 4 – Metodologjia e hulumtimit dhe modeli ekonometrik

Konkluzive dhe rekomandime

Bibliografia



## 1.6. Përfundimi

Të rinjtë në përgjithësi janë konsideruar dhe vazhdojnë të konsiderohen si një potencial zhvillimor i një vendi. Ato mund të japim kontribut të theksuar për ekonominë vendore dhe shoqërinë e tyre në përgjithësi. Por, mund të ndodh që ato humbin mundësi për fuqizim - posaçërisht gjatë tranzicionit nga shkollimi në punë dhe fatkeqësisht ky potencial zvogëlohet dukshëm.

Nga të dhënat që do të analizojmë do të nxjerrim konkludime dhe rekomandime adekuate sa i përket pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, cilat janë karakteristikat e kësaj kategorie të popullatës lidhur me tregun e punës, me çfarë sfidash ballafaqohet femrat e reja në tranzicionin e tyre nga mbarimi i shkollimit drejt gjetjes së një vendi pune, pra drejt tregut të punës.

Femrat mes tjerash janë në disavantazh ndaj meshkujve edhe për vetë faktin se janë femra dhe kjo i përcjell ato edhe në sfidat e tregut të punës. Në këtë punim të masterit do të mundohemi që mes tjerash të analizohen disa nga masat qeveritare që shënjestërojnë të rinjtë, në këtë kontekst femrat, si dhe cilët faktorë ndikojnë më së shumti në tranzicionin e femrave të reja nga procesi edukativ në tregun e punës.

## KAPITULLI 2 – SHQYRTIMI I LITERATURES MBI TREGUN E PUNËS NË RMV DHE PJESËMARRJES SË FEMRAVE NË TË

Vitet e fundit të ardhurat nga tregu i punës në Maqedoni dukshëm janë permisuar. Edhe pse shkalla e papunësisë është e ulët, mirepo nivelin më të lartë papunësisë e shënon në vitin 2015 me 26.1%. Kjo përqindje shënoj rritje në krahasim nga viti 2007 që ishte 36.2% në 42.1% në vitin 2015. Edhe pse ka pasur zhvillime dhe progress pozitiv në aspektin e punësimit, mirepo prap se prap mbetet një sfidë kryesore. Këto ndryshime janë të dukshme nga 55.7% në vitin 2007 në 57% në vitin 2015 përse duke qenë në nivelin më të ulët nga mesatarja e BE -28 me 72.4%. Në vitin 2017 qeveria prezantoi ALMP që trajtoi temën mbi papunësinë dhe pasivitetin e lartë që paraqet me këto objektiva kryesore (Petreski & Tumanoska, 2017):

- Përfshirjen e grupeve sociale të cilët cenohen të drejtat e tyre në tregun e punës
- Uljen e papunësisë
- Rritjen e punësueshmërisë për personat që janë të papunë që një kohë të gjatë
- Nxitjen e konkurrencës ekonomike

Politikat aktive të tregut të punës përfshijnë katër kategori me kryesore:

- Krijim i mundësisë pune të menjehershme
- Stimulime për punësim
- Praktikë
- Punë në komunitet (bashkësi)

Politikat aktive të tregut të punës suksesin e vet do ta vlerësoj nëpërmjet këtij hulumtimi që ka si qëllim kryesor të ndikoj në shkallën e papunësisë në vend.

Gjashtë vendet e Ballkanit kanë ngjajshmëri të njëjtë sa i përket kushteve dhe zhvillimeve në tregun e punës, këto vende janë dukshëm më keq krahasuar me vende të tjera në Europë

. Një tregues tjetër është edhe niveli shumë i ulët i punësimit, ku mesatarja e të punësuarve në vitin 2012 është 46 përqind më e ulët, krahasuar me vendet e zonës euro që janë me 64 përqind dhe 63 përqind janë shtetë e reja që janë anëtarë të Unionit Evropian.

Performanca e dobët e tregut të punës në vendet e Ballkanit është një shqetësim kryesor shoqëror - zvogelon rritjen ekonomike afatmesme dhe afatgjatë dhe paraqet sfida të mëdha për hartimin e politikave. Shkalla e ulët e punësimit nënkupton heqjen dorë nga prodhimi ndërsa të papunët rrezikojnë të humbasin aftësitë e tyre dhe kështu e bëjnë më të vështirë për veten e tyre që të gjejnë punë në të ardhmen. Ky cikël, nga ana tjetër, mund të rrisë normën natyrore të papunësisë.

Shkalla shumë e ulët e punësimit të të rinjve mund të pengojë procesin e përvetësimit të kapitalit njerëzor dhe të rrisë varësinë nga sistemet mbështetëse, duke zvogëluar potencialin e rritjes afatgjatë të shteteve. Më në fund, nivelet e larta të papunësisë krijojnë një barrë për financat publike në formën e përfitimeve më të larta sociale për të papunët dhe mund të zvogëlojnë kohezionin (bashkëveprimin) shoqëror.

Faktorë të ndryshëm mund të shpjegojnë rezultatet e tregut të punës.<sup>6</sup> Për vendet e Ballkanit, këta faktorë janë të organizuar në tre grupe (Kovtun, Meyer Cirkel, Murgasova, Smith, & Tambunlertchai, 2014):

- 1) Faktorët institucionalë të tregut të punës" me më shumë standarde , të cilat ndikojnë në lehtësinë me të cilën të papunët mund të përputhen me vendet e lira të punës. , dhe gjithashtu me të cilat firmat mund të rregullojnë punësimin;
- 2) Faktorët e kostos, të cilat tentojnë të rrisin pagat përkundër furnizimit të tepërt në tregun e punës, dhe që janë, në një farë mase, një reflektim i ngurtësive të përmbledhura nën faktorin e parë; dhe
- 3) Faktorët strukturorë të cilët janë më unikë, duke kapur proceset e tranzicionit të vendeve të Ballkanit dhe Integrimin Evropian, i cili duket se korrespondon me natyrën e vazhdueshme të problemeve të tyre në tregun e punës

Në periudhën midis 2012 dhe 2016, numri i të punësuarve në Republikën e Maqedonisë është rritur me 73,000 d.m.th. 11.2%. Shkalla mesatare e rritjes vjetore të numrit të të punësuarve ishte 2.8%. Numri më i madh i vendeve të reja të punës u vërejt në prodhim; ndërtimtari; tregti;

administratën publike dhe të mbrojtjes, si dhe në sigurimin e detyrueshëm shoqëror. Në vitin 2016, shkalla e punësimit në mesin e popullatës 15-64 vjeç ishte 49.1%. Megjithatë, ai ende mbetet në një nivel të ulët dhe tregon një përdorim të pamjaftueshëm të forcës punëtore si potencial zhvillimi. Hendeku gjinor në punësim është i lartë. Shkalla e punësimit të burrave me 58.6% në vitin 2016 është më e lartë se niveli i punësimit tek gratë që ishte 39.2% me dallim 19.4% .

Shkalla e punësimit tek të rinjtë është e ulët, që do të thotë, vetëm 16.2% e të rinjve të moshës 15-25 vjeç janë të punësuar. Një nga arsytet për këtë është niveli i ulët i aktivitetit të të rinjve me 31.3%, gjë që është kryesisht është shkaktuar nga pjesëmarrja e të rinjëve në sistemin arsimor. Pjesa e të rinjve (të moshës 15-29 vjeç) që nuk janë në punësim, arsim apo trajnim (NEET) është 31.3%, tek femrat e reja krahas djemve të rinj. Pra femrat e reja kanë më shumë mundësi që të mos jenë të përfshira në punë, arsim apo trajnim.

Pjesa e të punësuarve joformalë në numrin e përgjithshëm të të punësuarve është 18.5%, duke rënë me 4 % krahasuar me vitin 2012. Afërsisht gjysma e të punësuarve joformalë janë në sektorin e bujqësisë, dhe sipas statusit të tyre ekonomik, rreth gjysma e tyre janë punëtorë të papaguar të familjes. Për sa i përket pjesës së të punësuarve joformalë në numrin e përgjithshëm të të punësuarve sipas gjinisë, shkalla tek burrat është 20%, ndërsa shkalla tek gratë është 15%. Megjithë rënien e vazhdueshme të shkallës së papunësisë, Republika e Maqedonisë është ende përballë një niveli të lartë të papunësisë. Shkalla e papunësisë në vitin 2016 ishte 24% (një rënie nga 31.2% në 2012), dhe nuk ka dallime të mëdha gjinore.

Pavarësisht nga prirja pozitive, ekziston një shkallë e lartë e papunësisë tek të rinjtë, që shpresohet të bjerë me rritjen e nivelit të tyre arsimor. Ndër të rinjtë, shkalla e ulët e vendeve të punës të krijuara në tregun e punës si dhe shkalla e lartë e papunësisë rezultojnë në shkallë të lartë të papunësisë afatgjate (Government of Republic of North Macedonia, 2017).

Ne vitet e fundit shkalla e punesimit eshte relativisht e ulet (krahasuar me mesataren e BE-se te viti 2015 prej 70% vetem 52% e tyre jane te moshes prej 20-64 vjec) kurse per femrat kjo perqindje eshte edhe me e ulet (prej 42%) pra 20% te pikve me pak se tek burrat. Niveli i papunesis ngelet i larte mirepo kemi nje permisim te norms se papunsis ne vitin 2014 prej 28% dhe ne vitin 2015 per 26.1%. Kushtet e punesimit per moshen 15-24 ishte e tensionuar dhe e ndryshueshme ku ne vitin 2014 ishte me nje ulje prej 51.1% ndersa per vitin 2015 ishte prej 47.3%.

Ne vitin 2015 me shume se 80% e punekerkesve ishin te papune qe nje kohe relativisht te gjate. Ne pergjithesi tregu i punes ne nje vend karakterizohet nga nje nivel i ulet i aktiviteteve dhe nje rritje e punesimeve joformale, diskriminime gjinore, dhe nje nivel i larte i papunesimeve afatgjate. Shkaqet kryesore e kesaj gjendje te rende jane mangesit ne tregun e punes te cilat jane si pasoj e mungeses se aftesive dhe kualifikimeve te domesdoshme ne edukim dhe trajnim (European Training Foundation, 2020).

Nje ne kater prej te rinjeve nuk jane ne pune dhe nuk posedojn arsim dhe trajnim. Megjithate eshte nje rritje terciere e te rriturve ne arsim, dhe nje e pesta e fuqis punetore ka arsim fillor e kjo qe paraqet shkallen me te lart te edukimit. Mirepo pjesmarrja e edukimit pergjat gjith jetes mbetet ne nje nivel te kufizuar (prej 2.6 % ne vitin 2015).

Fuqia puntore shoqerohet me nivele te uleta te aftsive per kualifikim. Sidoqofte me shpejtesi po arrihen objektivat e EU2020 per arritje terciere (gati 29% e te rriturve te moshes 30-34 ne vitin 2015 kishin arsim terciar, nje rritje prej dy faktoreve ne vit qe prej 2010):

- 1) Eshte i dallueshem shkalla e arritjeve midis brezave: ne vitin 2015 43% e moshes prej 55-64 vjec kishin arsim te detyrueshem si nivel me te larte te edukimit, ndersa vetem 21% e te rinjeve ( te moshave 25-34) qe kishin nivel me te larte te arsimimit te detyrueshem.
- 2) Nje pasoj e mundshme e ketyre zhvillimeve mund te shpjegoje disa modele ne perdorimin e fuqise puntore. Pershkak kerkeses se dobet per punesim, shume

maturant te arsimit te larte punsohen ne vendet qe nuk kerkojn kualifikim, duke e mbajtur nivelin e papunesis te ulet duke lene boshellek per 10 pp krahasuar me puntoret me aftesi te ulet ( krahasuar me puntoret qe kane nivel te lart te arsimimit)

Ne vitin 2014 perqindja e studenteve me arsim te larte te regjistruara ne programet profesionale ishte 60%. Ne vend ka relativisht nje numer te larte per pjesmarrje te rinjeve prej 15-24 per arsim/trajnim, ku nga numri i pergjithshem pothuajse dy- tre te rinj marin pjese (mesatarja ne vitin 2015 ne BE ishte 70%). Kjo gjithashtu reflekton nje shkalle te ulet te largimeve te hershme (ne vitin 2015 vetem 11%), nga 15.5% ne 2010, AFP (vet) mund te jete nje tregues i suksesshem per ta tejkaluar mundesin e largimeve te hershme nga shkolla. Statistikat kryesore te tranzicionit nga shkollimi ne arsim (p.sh te rinjet te moshes 15-24 te cilet nuk jane as ne shkoll as ne pune as ne trajnime – NEET) nje e katerta e kesaj grupmoshe mbeten ne nivel relativisht te lart te qendrueshmeris krahasuar me vitin 2010. Kur vjen fjala per pjesmarrjen e te rinjeve ne trajnime, shifrat mbeten te uleta pa ndonje ndryshim ne vitet e fundit (European Training Foundation, 2016).

Mjedisi ne te cilin veprojn programet active eshte shume i rendesishem per efektivitetin e tyre te pergjithshem. Ne pergjithesi shume studime tregojn qe PATP jane me pak efektiv (nese ne te gjitha) ne nje suate qe shoqerohet me kerkes te ulet per punesime (Betcherman et al., 2004). Nga ana tjeter, disa nga programet active (te atilla sic jane subvencionimet per punesim dhe punesimet ne sektorin public) mund te kontribojn ne rritjen me te madhe te kerkeses per puntore, duke rritur drejtperdrejt edhe nivelin e punesimit. Keshtu qe tregu i punes ne Maqedonin e Veriut karakterizohet me papunesi relativisht te larte e cila qe nje dekada ka tentativa per renie por e shoqeruar me nje ritem te ngadalte (Mojsoska-Blazevski & Petreski, 2015).

Perkunder faktit qe shtetet ne vitin 1995 kane perfituar mireqenie te mire ne tregun e punes, mirepo tregu i punes perseri perballet me disa veshtiresi. Te dhenat statistikore nga Anketat Forces Puntore (LFS) tregojn se gjendja ne tregun e punes gradualisht eshte permisuar ne periudhen 2000-2011. Kjo periudh mund te dokumentohet si nje arritje ne punesime, me

shume pjesmarrje ne tregun e punes dhe ulje te papunesis. Edhe pse, treguesit baze ne tregun e punes ne vendin tone eshte larg nivelit mesatar te vendeve te BE-se (Radvansky, Stefanik, Weyerstrass, & Domonkos, 2013).

Republika e Maqedonise se Veriut po perballlet me nje perqindje te larte te papunesis, jobrazia dhe perjashtimet sociale ne shoqerin Maqedonase jane te larta. Gjithashtu numri i te papunesuarve te rinjeve ne vend eshte i larte, qe do te thote rrezik me i larte per pjesmarrja sociale. Pjesmarrja e te rinjeve ne tregun e punes eshte ne nivel te ulet. Ne vitin 2014 niveli aktiv per punesim isht 30.6%, punesimi 15.2%, dhe papunesia 50.4%.

Periudha e gjate e papunesis ndikon ne prespektivat e te rinjeve per te siguruar nje vend pune me mundesi perfitimi te karrieres apo edhe per nje page me te mire. Sipas mendimit tone ne te njejten suate ndodhen edhe te rinjet e papune te cilet perballen me nje rrezik te larte te marginalizimit, vecanerisht ato qe vijne nga familjet me status te ulet socio-ekonomik dhe nga zonat rurale te pazhvilluara.

Te rinjte e papunesuar ne tregun e punes jane ne nje pozite te pafavorshme ne krahasim me kategorit e tjera te te papunesuarve. Arsyet me te rendesishme per papunesin e te rinjeve jane:

- Struktura e dobet per kualifikim (numri i larte i te rinjeve si te pakualifikuar ose gjysem te kualifikuar);
- Mosperputhja midis nevojave te tregut te punes dhe sistemit arsimor;
- Kerkesa strikte nga ana e te punesuarve per puntor me pervoj pune
- Rritja e ashtuquajtures ekonomike e zeze, ku njerezit defakto jane te punesuar, mirepo ne entin per punesim paraqiten sit e papune qe te perfitojn nga sigurimi social shendetesor.


Papunesia tek te rinjet ka pasoja te medha ne personalitetin dhe te ardhmen e tyre, por edhe ne komunitetin ne te cilin ata jetojn. Te rinjet e papune e kane te veshtir te panvarsohen ne shoqeri dhe keshtu ata perfundojn ne izolimin social dhe politik.

Sipas hulumtimit pasojat negative qe vijin si shkak i papunesis tek te rinjet kalon neper disa nivele:

Cdo dite e kaluar ne periudhen e papunsis zvoglohen mundesit per punesim te ardhshem, dhe rritet rezikshmeria per varferim. Per me teper papunesia zvogelon shanset per te ardhmen per pune me fiitim te mire.

Njerezit e papune gjithashtu humbasin mundesin per ti krijuar kontaktet e nevojshme per sukses ne tregun e punes dhe kjo munges e ndertimit te kapitalit social eshte njera nder shkaqet per plasime te keqija ne te ardhmen ne tregun e punes. Papunesia rrit fenomenet antisociale dhe deviante, dhe gjithashtu rrite edhe pabarazin ndermjet grupeve te ndryshme shoqerore. Analizat tregojn se te rinjet qe I perkasin grupeve te margjinalizuara qe jane te papune ose vijn ose jetojne ne vende te lene pas dore/ ose te braktisura (Национален извештај за младинската невработеност во Република Македонија, 2015).

Figura 1- Norma e papunësisë në RMV



Burimi: Banka popullore e RMV & Banka Botërore, Enti i Statistikave të RMV

Republika e Maqedonisë pasi fitoi panvarsin me referendumin qe u mbajt nga RSFJ ne vitin 1991 doli si republika me e varfer ne Europ me nje numer te normes papunsis prej 24.5. Ekonomia e vitit 1991 isht si pasoj i nje numri faktoresh nder to jane: shperberja e tregut, luftrat



me vendet ish-Jugosllave, bllokad tregtare ne kufirin me Greqin, sanksione ekonomike kunder vendeve FR Jugosllave, etj. Keto faktor parandaluan per nje rritje ekonomike duke shoqeruar ate me nje norme papunsie me te lart ne Europë. Numri i papunesis vazhdon te rritet edhe ne vitet 1993-1994 prej 27.7 ne 30.0 e ndikuar nga kirizat ekonomike-politike te shteteve fqinje (Serbis dhe Malit te Zi) me c rast u bllokuan edhe transportet dhe eskportet ne vend. Goditja e radhes kundrejt shtetit tone vjen menjeher ne vitin 1994 ku mosmarveshjet me Greqin pershkak emrit penalizojn perseri importet dhe eksportet mbi produktet ne tregun Maqedonas duke bllokuar kalimin e tyre neper territorin e Greqis. Pra ne kete periudh ekonomia perjetoi nje trysni te madhe nga njera ane nga sanksionet ne veri kurse nga ana tjetere nje embargo ne jug me nje ulje te bruto prodhimit vendor prej me shume se 80%<sup>1</sup> duke pesuar renie deficitit tregtar ne vend.

Numri i papunesis fillon te rritet edhe gjate periudhes se privatizimit te viti 1995 me nje norme prej 35.6 Edhe pse mendohet qe me rritjen e privatizimit ne proporcion te drejt do te rritet edhe numri i investimeve dhe kjo do te zvogelonte papunesin mirepo tek ne ndodhi e kunderta. Ne kete periudh numri i papunesis u rrit ndjeshem.

Ne vitin 1996 si pasoj e renies se Bruto Prodhimit vendor kemi nje rritje te normes papunsis prej 38.8 duke paraqitur niveli me te larte te papunsis qysh nga panvarsia e RM-se. Edhe pse ne fillim te muajit prill te vitit 1996 parlamenti i RM-se miratoi nje ligj per privatizimin e nderrmarjeve buqesore te cilat po te njejta nuk arriten te kalonin fazen e pare te privatizimit<sup>2</sup>. Niveli i lart i papunesis ne kete vite ishte si pasoj edhe i uljes se prodhimit dhe konsumit ne vend.

Norma e papunësisë fillon te kete nje renie ne vitin 1997 prej 2.8 e cila arrin ne 36 . Kurse ne vitin 1998-2001 kemi renie te normes se papunsis, ku ne vitin 2001 arrin deri me 30.5. Pra prej vitit 2001-2010 kemi nje trend te rritjes ne numrin e papunsis. Deri vitin 2016 kemi nje renie prej 23.7 qe arrin te tejkalon normen e papunsis qe nga vet panvarsia e RM-se. Kjo

---

<sup>1</sup>[https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%95%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%98%D0%B0\\_%D0%BD%D0%B0\\_%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0](https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%95%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D0%BD%D0%B0_%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0)


<sup>2</sup> Агенција на Република Македонија за трансформација на претпри-јатијата со општествен капитал (1996), стр. 9.

tendenc e uljes se papunsis vazhdon deri me vitin 2019 qe arrin 17.3 me crast ne kete faze ekonomia gjendet ne fazen e ekspanzionit ku kemi rrtje te kerkeses dhe ofertes per punësim.

Shkaktar kryesor per uljen e vazhdueshme te numrit te papunsis ne kto vitet e fundit eshte nga politikat qe jane nderrmar nga Qeveria e RM-se. Kjo vjen edhe si pasoj e disa ndryshimeve sic jane terheqja e investimeve te huaja dhe krijimin e vendeve te punes, heqja nga lista papunet qe jane perfitues te subvencioneve, poashtu edhe nje faktor i rendesishem eshte emigrimi i te rinjeve jasht vendit.

Perkunder shume goditjeve te forta ekonomike ne papunesi perseri ekonomia Maqedonase ka treguar qe ka forc dhe mundesi per te dal nga kriza dhe per te krijuar kushte qe ti arrij nivelete me te larta dhe me te qendrueshme te rritjes ekonomike.

Figura 2 - Norma aktive dhe norma e punësimimit në RMV



Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017

Nga tabela eshte e dukshme tendenca e rritjes se vazhdueshme te normes se punesimit ku ne vitin 2007 kjo norme eshte prej 36.2% e cila rritet deri ne 44.1% e cila paraqet shkallen me te larte te punesimit. Kurse nga viti 2011 vlen te potencohet inicativa e Qeveris qe

ndermori disa hapa sic jane: trajnimet te personave te papune per inkurajim per vetpunsim qe rriti normen e punesimit prej 38.9%, ne ate menyre duke i pergaditur se si te perballohen me sfidat e tregut sipermarresit e rinj, gjithashtu edhe ne pergaditjen e planeve biznesore, regjistrim te bizneseve pa pages, si dhe ne mbeshtetjen financiare. Periudha e viteve 2011-2017 i kemi edhe subvencionet e punesimit te jetimorve, si dhe prinderit qe jane te divorcuar dhe te moshuarve 55-62vjet ne shume prej 15.000den ne menyre qe te gjithe keto grupe ndermarjet ti mbajn ne pune prej 12 mujave dhe kjo solli ne rritjen e normes se punesimit. Kurse vitin 2012-2013 kemi nje diferenc ne rritje prej 1.6 % te normes se punesimit. Nga tabela verejm se ne vitin 2014-2015 perqindja eshte e njejte prej 42.1%. Nga ana tjeter shohim qe norma aktive per punesim eshte ne nje trajektore konstante ku aty ketu kemi ca levizje te vogla jo shume te dallueshme krahasuar me normen e punesimit. Norma aktive me e theksuar ka qene ne vitin 2014 me perqindje prej 57.3%, ku ne vitin ne vazhdim kjo norm bie per 0.3% kryesisht ne 57.0% dhe kjo renie vazhdon deri ne vitin 2017 me 56.8, por perseri paraqet nje vler me te larte krahasuar me ate te vitit 2007 qe kishte nje nivel me te ulet nga te gjithe parametrat e vlersuar per periudhat ne tabel ku kjo perqindje eshte prej 36.2%. Kurse per periudhen e vitit 2009-2011 perqindja e normes aktive per punesim levizen me nje ndryshim prej 0.2% -0.3%.

*Tabela 1 - Norma e punësimit, papunësisë dhe aktive, sipas gjinisë*

	Viti	Gjinia	
		Mashkull	Femër
<b>NORMA E PAPUNËSISË</b>	2010	31.9	32.2
	2011	31.8	30.8
	2012	31.5	30.3
	2013	29.0	29.0
	2014	27.6	28.6
	2015	26.7	25.1
	2016	24.4	22.7
	2017	22.7	21.8
<b>NORMA E PUNËSIMIT</b>	2010	47.5	29.8
	2011	47.0	30.9
	2012	47.1	30.8

	NORMA AKTIVE	2013	48.7	32.5
		2014	50.1	32.4
		2015	50.5	33.7
		2016	52.3	33.8
		2017	53.6	34.6
		2010	69.8	44.0
		2011	68.8	44.7
		2012	68.7	44.3
NORMA AKTIVE	NORMA AKTIVE	2013	68.5	45.8
		2014	69.3	45.3
		2015	68.9	44.9
		2016	69.2	43.8
		2017	69.3	44.3

Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017 (Enti shtetëror i statistikave).

Mashkullore paraqitet me 31.9 kurse per gjinin femore eshte me e larte prej 32.2 me nje dallim prej 0.3 per gjinin femrore kjo norme eshte me larte, ne vitin e ardhshem dmth ate te vitit 2011 norma e papunsis per gjinin femrore bie ne 30.8 krahasuar ate me gjinin mashkullore qe eshte prej 31.8, me nje avantazh prej 1 per gjinin femerore, perqindja e kesaj norme cdo vit bie nga pak kurse ne vitin 2013 per dy gjinit mbetet e njejt prej 29, me pas ne vitin 2014 kjo norme paraqitet me nje perqindje ca me te larte per gjinin femerore prej 28.6 kurse per gjinin e mashkullore prej 27.6 kurse ne vitin 2015 kjo perqinje ndryshon per gjinin femorore duke pasur nje renie pozitive prej 25.1 krahasuar me ate te gjinin mashkullore prej 26.7, kurse ne dy vitet e tjera dmth te vitit 2016-2017 norma e papunsis perseri paraqitet me e ulet tek gjinia femrore ku prej 22.7 zbret ne 21.8, kurse tek gjinia mashkullore prej 24.4 ne 22.7.

Edhe indikator i dyte punesimi qe nga viti 2010 paraqitet me nje avantazh shume me te larte per gjinin mashkullore prej 47.5 kurse per gjinin femerore kjo norme dukshem eshte me e ulet prej 29.8, pas ketij viti norma e punesimit per gjinin bie ne 47.0 edhe pse kemi nje rritje ne nomren e punesimit tek femrat per 30.9 mirepo perseri kjo nuk ndihmon ne tejkalimin e kesaj norme krahasuar ate me gjinin e kundert. Ne vitin 2012 norma e punesimit tek meshkujt rritet

ne 47.1% kurse te gjinia femrore arrin ne 30.8, poashtu ne vitin 2013 kemi nje rritje prej 1.6 te normes se punesimit per meshkuj kurse tek femrat prej 1.7 qe ne total arrin ne 32.5 perseri kjo norme eshte jomjaftusheme krahasuar me gjinin mashkullore. Kurse nje rritje me evidentueshme te normes se punesimit per gjinin mashkullore paraqitet edhe ne vitin 2015 me nje norme prej 50.5 dhe vazhdon ky ritem edhe per vitin 2016 me 52.3 dhe arrin deri ne 53.6 ne vitin 2017, kurse normat e punesimit per gjinin femrore lene per tu deshiruar qe ne vitin 2015 arrijn ne 33.7 me pas vijojn ne 2016 me 33.8 dhe ne vitin 2017 me 34.6. Krahasur e indikatorin e pare qe ishte papunesia edhe pse tek femrat shpesh normat ishin me te uleta krahasuar me gjinin mashkullore mirepo perseri keto norma nuk kan ndikuar ne ndryshimin e punesimit per gjinin femrore.

Dhe indikatorin e tret qe i jep esenc gjithë analizes sone ka te bej me normen aktive te punesimit ku per gjinin mashkullore ne vitin 2010 dukeshem eshte me e larte me nje norme prej 69.8 kurse kjo norme eshte me e ulet prej 25.8 diferenc pra prej 44.0, ne vitin 2011 kemi nje rritje prej 1% per tek gjinia mashkullore kurse gjinia femrore arrin normen prej 44.7 me tej vazhdojm ne vitin 2012 ku kemi normen aktive per gjinin mashkullore prej 68.7 kurse per gjinin femrore ne 44.3, kurse per vitin 2013-2014 kemi nje rritje te normes aktive prej 68.5 ne 69.3 kurse per gjinin femrore prej 45.8 ne 45.3 niveli me i larte i mundeshem i normes aktive ku pas ketyre viteve norma e aktive per punesim per gjinin femrore bie 44.9 ne vitin 2015 dhe me pas ne 2016 ne 43.8 dhe ne 2017 kjo norme arrin ne 44.3, kurse kjo norme pas vitit 2015 qe paraqitet me 68.9 dukshem rritet per vitin 2016-2017 prej 69.2 ne 69.3.

*Tabela 2 - Papunësia afatgjate në RVM (sipas gjinisë)*

Papunësisë afatgjate	Vitet										
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
% e papunësisë afatgjate <sup>3</sup>	<b>84.9</b>	<b>84.9</b>	<b>81.9</b>	<b>83.3</b>	<b>82.6</b>	<b>82.1</b>	<b>82.5</b>	<b>83.4</b>	<b>81.6</b>	<b>80.9</b>	<b>77.9</b>
• <b>Meshkuj</b>	84.7	86.0	82.5	83.7	83.6	83.0	82.7	83.6	82.5	82.5	77.5
• <b>Femra</b>	85.1	83.3	80.8	82.7	81.0	80.7	82.2	83.1	80.2	78.2	78.6
Norma e papunësisë afatgjate <sup>4</sup>	<b>29.7</b>	<b>28.7</b>	<b>26.3</b>	<b>26.7</b>	<b>25.9</b>	<b>25.5</b>	<b>23.9</b>	<b>23.4</b>	<b>21.3</b>	<b>19.2</b>	<b>17.4</b>

<sup>3</sup>% e papunësisë afatgjate – pjesëmarrja e personave të papunë për periudhe kohore më shumë se 1 vjet në totalin e personave të papunës

• <b>Meshkuj</b>	29.3	28.8	26.2	26.7	26.6	26.1	24.0	23.1	22.1	20.1	17.6
• <b>Femra</b>	30.3	28.5	26.5	26.7	24.9	24.5	23.8	23.8	20.1	17.8	17.2

Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017 (Enti shtetëror i statistikave)

Sigurisht që në kuadër të viteve kemi edhe ndryshime në përqindjen dhe normën e papunësisë afatgjatë si për femra ashtu edhe për meshkujt. Nga viti 2007 përqindja e papunësisë në periudhë afatgjatë në përgjithësi ishte 84.9% kurse për gjinin mashkullore fillon me 84.7% kurse kjo përqindje për femrat është më e lartë për 1.6%. Kurse me kalimin e vitetve shohim një zbritje të kësaj përqindjeje ku në vitin 2017 arrijnë në 77.9% papunësia afatgjatë. Gjithashtu verjëm një ulje të kësaj përqindjeje edhe për tek gjinia mashkullore poashtu kemi ulje të njëtrajtshme edhe për gjinin femrore. Në vitin 2017 përqindja e papunësisë në terma afatgjatë bie në 77.5% kurse për tek gjinia femore në 78.6%.


Edhe pse nuk kemi një ndryshim të theksuar mirëpo perseri ndryshimi prej 1.1% tregon që gjinia mashkullore ka një avantazh më të lartë në kuadër të gjinisë femore në tregun e punës. Në vitin 2016 përqindja e papunësisë afatgjatë tek femrat ishte më e ulët në vitin 2016 me 78.2% krahasuar atë me vitin 2017. Në vitin 2009 kjo përqindje bie në 80.8% për gjinin femore kurse për gjinin mashkullore 82.5%, pra një papunësi paksa më e ulur për gjinin femore ku pas këtij viti pason një rritje prej 1.9% pra në vitin 2010 në 82.7%. Gjithashtu edhe për tek gjinia mashkullore një rritje prej 1.2% pra arrijnë në 83.7%. Kurse diferenca pak sa më e theksuar është ajo e vitit 2012 ku për gjinin mashkullore është prej 83% kurse për gjinin femore prej 80.7% me një diferencë prej 3.7% më e ulët tek gjinia femore. Norma e papunësisë afatgjatë që nga viti 2007 e cila paraqitet me 29.7 shkon çdo vit në rënie ku në 2017 arrijnë në 17.4. Pra ky trend rënes shoqërohet njëjtë tek dy gjinit. Në vitin 2007 norma e papunësisë afatgjatë tek meshkujt është 29.3 kurse për gjinin femore kjo normë është më e lartë për 1 shkallë, pra 30.3. Kurse pas këtij viti shohim se kjo normë është më e theksuar tek gjinia femore e cila është prej 28.5 kurse për gjinin mashkullore është prej 28.8. Kurse në vitin 2010 për dy gjinit kjo normë mbetet e njëjtë, ndërsa në vitin 2012 fillon perseri një ulje më e theksuar për gjinin femore prej 24.5 kurse kjo normë është më e lartë për gjinin mashkullore për 26.1. Dhe kjo trajektore vazhdon edhe për vitet në

---

<sup>4</sup>Norma e papunësisë afatgjatë- pjesëmarrja e personave të papunë për periudhë më të gjatë se 1 vjet në normën e përgjithshme të fuqisë punëtore

vazhdim ku ne vitin 2013 kemi nje ndryshim prej 0.2 per gjinin femore, ne vitin 2014 prej 0.7 ne vitin 2015 vazhdon ndryshimi prej 1.1, vitin 2016 prej 2.3 nje norm me te ulet te papunsis per gjinin femrore.

Figura 3 - Punësimi formal kundrejt punësimit joformal



Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017 (Enti shtetëror i statistikave)

Raporti midis punesimit formal karshi atij joformal eshte ne nje raport te zhdrejt, ku ne vitin 2007 punesimi formal eshte prej 72.4% ne vitin 2007 kurse kjo perqindje ne vitin 2008 eshte ne renie prej 1% pra 71.4% ku ne vitin 2009 rritet per 73.00% dhe ky trend rrites shoqerohet edhe ne vitite ne vazhdim me nje diferenc ne rritje prej 1.2 ne vitin 2010 prej 73.8% rrtja vazhdon ne 75% ne vitin 2011 kurse per vitin 2012-2013 verejm se kjo perqindje mbetet e njejte per punsimet formale prej 77.5% kurse ne vitin 2012 bie ne 77.4% kurse pas ketij viti pra ate te vitit 2015 kremi nje rritje ne 80.10% dhe vazhdon rritja deri ne vitin 2017 ne 81.9% praj ketu arrin edhe kulminacionin punesimi formal ne suazat e hendekut brenda 10 viteve e cila paraqitet me nje perqindje te punesimeve formale prej 81.9%. Nga ana tjetere punesimet joformale ne vitin 2007 paraqiten me 27.6% ku pas ketij vitit kjo perqindje rritet ne 28.6% dhe me pas shoqerohet ne nje renie prej 1.6% perseri edhe ne vitin 2010 shoqerohet me nje renie prej 1.2% nga viti paraprak e cila ne vitin 2011 arrin ne 25.0%, ku ne vitin 2012-2013 kjo perqindje eshte e pandryshueshme prej 22.5% ku ne vitin 2014 rritet per 0.1% pra e cila arrin

ne 22.6% dhe me pas shoqerohet me nje ulje prej 2.7% pra nje zhvillim pozitiv ne uljen e punesimeve joformale ne vitin 2015 e cila vazhdon ne renie deri ne vitin 2017 prej 18.1%.

## **KAPITULLI 3 – SFIDAT DHE KARAKTERISTIKAT E PERIUDHES SE KALIMIT TË FEMRAVE TË REJA NË RMV NË TREGUN E PUNËS**

### **1. Shkollimi i mbaruar**

Ne vitin 2014 vetem 57.5 perqind e te rinjeve kane perfuduar shkollimin e tyre. Kurse vetem nje pjese e te rinjeve e perfaqesuar me 1.5 perqind nuk kane ndjekur shkollimin ku ka edhe prej tyre (me 2.4 perqind) qe kane braktisur shkollimin ne prag te diplomimit ndersa pjesa tjeter e mbetur prej 38.7 perqind vazhduan studimet e tyre dhe me crast edhe shkollimin e tyre.

Prej 11.1 perqind e shumices se te rinjeve ne IRJ te Maqedonis se Veriut se paku kane kryer shkollimin e mesem ne drejtimin e pergjithshem, kurse ne drejtimin e arsimit profesional (te shkollimit te mesem ose ati pas te mesem) me nje perqindje prej 43.0 dhe me nje total prej 26.7 perqind per nivelin e arsimit universitar (kete me mire e paraqesim ne tabelen 3.2). Por mos te harrojm edhe arsimin fillor qe perfaqeson nje nivel prej 3.2 perqind. Nese marim te krahasojm vitin 2012 shohim nje peshmarrje me te larte te arsimit te larte ( pra 10.2 perqind duke e krahasuar me arsimin e pergjithshem nedrejtimin te pergjithshem I cili eshte me 11.1 perqind dhe 21.2 perqind krahasuar me 26.7 per arsimin e larte). Kjo perqindje eshte me e larte per te rinjet e moshave prej 25 deri 29 vjece krahasuar me ate te vitit 2014.

*Tabela 3 - Niveli I shkollimit I te rinjeve ne vitet 2012 dhe 2014*

Shkollimi me I larte I kryer	2012			2014		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra



<b>Para fillore</b>		3.5	3.5	3.6	3.2	1.2	5.4
<b>Fillore</b>		22.2	19.1	25.7	16.0	12.5	20.0
<b>E mesme</b>		10.2	10.3	10.1	11.1	12.4	9.7
<b>Profesionale<sup>5</sup></b>		42.9	51.5	33.2	43.0	54.9	29.5
<b>E lartë</b>		21.2	15.6	27.4	26.7	19.0	35.4
<b>Gjithsej</b>		100.0	100.	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Anketat e fuqisë punëtore për vitet 2007-2017 (Enti shtetëror i statistikave)

